

Portret aktivisti në diasporë

Emërllah Sejdiu, drugëza e shqiptarisë

Nga viti 1988 Emërllahu u bashkohet aktivistëve të Klubit të shqiptarëve "Jehona" në Nyrnberg. Kjo ishte koha kur fillon lëvizja shqiptare për organizimin e tubimeve, demonstratave dhe protestave antijugoslave ku ai gjendej përkrah aktivistëve në këtë qytet të Gjermanisë dhe dalëngadalë bëhet ndër aktivistët më të zellshëm për çështjen shqiptare në atë mes

Hamza Halabaku

Emërllah Sejdiu është i lindur para gjashtëdhjetë vjetësh në fshatin Leshnicë të Komunës së Tetovës. Pas tërmetit që e kishte goditur Shkupin në vitin 1963, Emërllahu kishte dëshirë të regjistrohej në Shkollën Normale "Zef Lush Marku" në Shkup. Megjithatë nuk ia kishte arritur qëllimit pasi që shumë shkolla të mesme nuk funksiononin pas asaj katastrofe natyrore.

Në shenjë solidariteti Emërllahun dhe disa shokë të brezit të tij i kishin marrë për t'u shkolluar në Slloveni. Emërllahu vendoset në Maribor dhe aty e mbaron shkollën e mesme për axhustatorë në vitin 1967. Më pastaj ai punësohet në një fabrikë ku edhe kryen punë të një axhustatori të ri. Pas mbarimit të shërbimit ushtarak, në vitin 1969, vendoset në Austri, kurse pas dy vjetësh në Nyrnberg të Gjermanisë, ku punësohet në Fabrikën e turbinave "Kanis". Në atë fabrikë Emërllahu lavdërohet, shpërblehet dhe laureohet me disa mirënjohje.

Nga viti 1988 Emërllahu u bashkohet aktivistëve të tjerë të tubuar në Klubin e shqiptarëve "Jehona" në Nyrnberg. Kjo ishte koha kur fillon lëvizja shqiptare për organizimin e tubimeve, demonstratave dhe protestave antijugoslave ku Emërllahu ishte përkrah aktivistëve në këtë qytet të Gjermanisë dhe dalëngadalë bëhet ndër aktivistët e parë dhe më të zellshmit për çështjen shqiptare në atë mes.

- Filluam me tubimin e mjeteve për Televizionin e Prishtinës dhe vazhduam për Fondin për të Drejtat e Njeriut, për Sindikatën e Pavarur



Emërllah Sejdiu

të Kosovës, pastaj aksionin "Familja ndihmon familjen" etj. Po ashtu, formuam Degën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Nuk kam qenë asnjëherë as kryetar i Klubit "Jehona" e as kryetar i Degës së LDK-së, thotë Emërllahu, por kam qenë arkëtar e shpesh edhe sekretar edhe i klubit e edhe i LDK-së. Puna më e madhe që kemi bërë në Nyrnberg padyshim se është grumbullimi i mjeteve të trespërqindshmit. Kemi punuar pa pushim. Asnjëherë nuk kemi menduar as për shpenzimet tona individuale. Kemi vepruar qoftë nëpër tubime, protesta e demonstrata po edhe për të vrapuar për grumbullimin e mjeteve për mbijetesën e qytetarëve shqiptarë në Kosovë. Edhe sot i ruaj të gjitha dëftesat për mjetet e grumbulluara dhe të dorëzuara. Ishin shumë mjete për të cilat kishte nevojë arsimit, kultura e shëndetësia kosovare e atyre viteve. Kemi tubuar mjete edhe për UÇK-në. Nuk lodheshim fare, sepse ishin përpjekjet

tona për realizimin e aspiratave tona shekullore për formimin e shtetit tonë, ndaj duhej ndihmuar pa kursyer as forcën e as mjetet. Ka kaluar një kohë, dhe tani jam në moshë, po nuk mund ta harroj bashkëpunimin me Gani Shalën, Enver Rexhepin, Remzi Hetën, Metush Zagrahën e shumë e shumë të tjerë, thotë Emërllah Sejdiu. Njëri nga shokët me të cilët ka bashkëpunuar Emërllahu, aktivisti i atëhershëm, Gani Shala, kur flet për Emërllahun, pa u hamendur thotë: "Ishte ndër aktivistët e palodhshëm dhe më i zellshmi nga të gjithë ne. Nuk dinte të lodhej. Ne na jepte kurajë edhe pse ai nuk ishte nga Kosova. Me një pedanteri i kryente të gjitha detyrat. Dhe për çdo punë mbante shënime. Nuk i dhimbsej as koha e as vetura. Emërllahu përveç punëve që kryente vetë, na nxiste edhe ne aktivistëve që të dalloheshim nga ata që paguanin trespërqindshin". Remzi Heta, po ashtu aktivisti i kohës, thotë se po të kisha mundësi do të ndikoja në Qeverinë e Republikës së Kosovës për ta laureuar me mirënjohje apo me ndonjë formë tjetër Emërllahun.

Tani që nga viti 1998 Emërllah Sejdiu është i sëmurë. Vuan nga një sëmundje e rëndë. Dhe sa herë e viziton miqtë, atë e gjejmë me njërin nga gazetaret tona të përditshme që botohen në diasporë. Bile, edhe në dritaren e banesës së tij, për çdo festë shqiptare valon Flamuri Kombëtar shqiptar.

Nga fillimi i njohjes së Republikës së Kosovës nga shtetet e ndryshme, Emërllahu për ditë e mban evidencën e njohjeve me radhë. Emërllahu gëzohet shumë sa herë që shtohet numri i shteteve që e njohin pavarësinë e Kosovës.

Nënat integrohen

Kursi: "Nënat mësojnë gjermanisht", një ndihmë më shumë

Në Vjenë është hapur një kurs falas për nënat, që vepron në shkollat e afërta ku vijnë mësimin edhe fëmijët e tyre. Organet kompetente apelojnë te gratë me prejardhje të huaja që t'zi ndjekin kurset e ofruara. Kjo u krijon mundësi më të mëdha për punësim dhe jetë normale



Pjesëmarrëse të kursit "Nënat mësojnë gjermanisht" në Vjenë

Hazir Mehmeti, Vjenë

Në Vjenë, kryeqytetin austriak ku prezenca e të ardhurve është më e theksuar, nevoja për përkujdesje në integrimin shoqëror të tyre është një prioritet i organeve administrative pranë Ministrisë për Integrim. Në kuadër të kësaj ishte parë me përparësi që të ndihmohej nëna, si person me rol të veçantë në familje. Pas shumë debatesh të zhvilluara pranë organeve arsimore e administrative u vendos themelimi i një kursi falas për nënat, në shkollat e afërta ku vijnë mësimin edhe fëmijët e tyre. Për fëmijët parashkollorë kujdesen mësueset e përgatitura për këtë profesion derisa nënat vazhdojnë mësimin. Kjo ishte një lehtësim i madh për mirëvajtjen e kursit. Një mësuese shqiptare e kyçur në këtë mësim, e cila dëshiron të mbetet anonime thotë: "Ishte privilegj të ndihmoje fëmijët e nënave derisa ato bëjnë hapat fillestar në mësimin e gjuhës gjermane. Kishte mjaft nëna shqiptare, kryesisht të ardhura nga viset rurale të atdheut, me një njohuri jo të mirë të gjuhës amtare. Ato me përkushtim i përcillnin mësimet e gjuhës edhe pse dihet se barra kryesore e familjes

bie mbi to. Mentaliteti ynë nga njëherë primitiv ndaj femrës e pengon progresin e saj këtu. Megjithatë femrat shqiptare po bëjnë hapa të rëndësishëm në integrimin e tyre krahas kombeve tjera. Nuk është i pakët numri i atyre që gjenden në vende pune me rëndësi".

Edhe gjatë verës ofrohen mundësi të shumta të vazhdimin të kurseve të gjuhës gjermane për të rritur dhe nxënës. Ato janë pa pagesë. Andaj organet kompetente apelojnë te gratë që t'i ndjekin kurset e ofruara. Kjo u krijon mundësi më të mëdha për punësimin dhe jetë normale. Janë vënë edhe kushte të caktuara në bazë të të cilave kërkohet vërtetimi mbi mbarimin apo vazhdimin e kursit përkatës, për të mundur të sigurohet ndihma sociale, marrja e nënshtetësisë etj. Nënat e nxënësve shqiptarë po ndihmohen edhe nga mësuesit/et shqiptare përmes formave të ndryshme: informimit, teksteve të nevojshme. Numri i familjeve shqiptare të ardhura tani është i vogël si rezultat i rrethanave të reja në territoret etnike. Kursi i këtij viti mbaroi me sukses krahas mësimin të rregullt dhe atij plotësues në gjuhën amtare.

Manifestim në përfundim të vitit shkollor

Ruaje gjuhën, se gjuha të ruan ty!

Bashkësia Shqiptare e Kantonit Jura të shtunën më 21.06.08 duke filluar nga ora 18 -20.30 në Restorantin "Dardana" rute principate 11 në Choindex (Drejtimi Delemont - Moutier- Delemont) organizon manifestim kulturor me moton " Ruaje gjuhën, se gjuha të ruan ty". Ky aktivitet lidhet me përfundimin e vitit shkollor të shkollës shqipe. Edhe pse gjende mi larg vendlindjes, secili prej nesh, me trup e zemër jemi të pandarë nga atdheu. Kjo përzemërsi se jemi shqiptar nga toka shqiptare, na bashkon për çdo vit

gjuha shqipe festa e identitetit tonë. Shumë këngë, valle, recitime, skeç, në gjuhën e ëmbël shqipe, do të ju afrojnë nxënësit e shkollës shqipe. Fëmijët duke mësuar gjuhën shqipe, ata do ta pasurojnë kulturën e tyre, traditat dhe zakonet e mira që populli ynë i ka trashëguar në shekuj.

Manifestimi edhe kësaj radhe është konceptuar në dy pjesë: Programi shkollor, përgatitur nga mësuesja Nexhmije Mehmetaj dhe Pjesa e dytë, program muzikor.

(N. Mehmetaj)

Atelie Teatore "Kurora 2008"

Teatri në shërbim të integritimit

Atelietë e Teatrit Kurora me anë të lojërave teatore do të favorizojnë takime dhe kontakte në mes të të rinjve që do të ju mundësojë të njihen, të kenë lidhje në mes tyre dhe njëherësh në mes të shoqatave të ndryshme të regjionit të qytetit të Nionit

Migjen Kajtazi

Teatri Shqiptar "Kurora" nga qyteti i Nionit të kantonit Vaud vepron prej më shumë se 14 vitesh. Por, ka 4 vite që ky teatër është shumë aktiv në fushën e integritimit. Këtë vit "Kurora" organizon atelie (punëtori) teatore që u drejtohen posaçërisht migrantëve të cilët do jenë ndërkohë edhe aktorët kryesorë të atelie teatre.

Ky projekt ka për qëllim që migrantëve që angazhohen në këtë projekt tua mundësojë të marrin sa më shumë kapacitete sociogjuhësore duke zhvilluar njëkohësisht vetëbesimin por edhe besimin te të tjerët.

Atelietë e Teatrit Kurora me anë të lojërave teatore do të favorizojnë takime dhe kontakte në mes të të rinjve që do të ju mundësojë të njihen, të kenë lidhje në mes tyre dhe njëherësh në mes të shoqatave të ndryshme të regjionit të qytetit të Nionit.

Pjesëmarrësit në këtë projekt do të kenë rastin të punojnë së bashku dhe të zhvillojnë aftësi në komunikim dhe në mirëkuptim të ndërsjellë.

Me ushtrimet në kuadër të aktiviteteve teatore, të rinjtë shprehin por edhe dëgjojnë të tjerët por njëkohësisht mësojnë të dëgjojnë ... Kjo do të ju japë atyre mundësi për zhvillimin jo vetëm të shprehjeve gjuhësore por edhe atyre jo gjuhësore



Një shfaqje e teatrit "Kurora"

sore të cilat janë shumë të nevojshme për rritjen e kapaciteteve të të rinjve në aspektin e vetëbesimit.

Prandaj, në këtë fushë të kapaciteteve kërkohet një investim në vete i cili është i rëndësishëm jo me qëllimin që këta të rinj që marrin apo që do të marrin pjesë në këtë projekt të teatrit Kurora të bëhen më të mirë se të tjerët por që këta të rinj të japin më të mirën nga vetvetja...

Kurora me anë të këtij projekti do të prekë edhe një temë po ashtu shumë të rëndësishme si informimi dhe sensibilizimi i të rinjve dhe prindërve me origjinë të huaj për sistemin shkollor të komunës së qytetit të Nionit dhe për këtë teatri Kurora ka vënë në shërbim një linjë telefonike për të shërbyer në këtë drej-

tim. Ky projekt mbështetet financiarisht nga Zyra Federale për Migrantë e Zvicrës, nga koordinatori kantonale për Integrimin të të huajve në Kantonin Vaud, zonja Magaly Hanselmann, si dhe nga komuna e qytetit i Nionit.

Për më shumë informata ju lutemi t'i drejtoheni koordinatorit të këtij projekti të teatrit "Kurora", zotëri Visar Qysaj në numër telefonik : 079 359 65 17 apo në adresën elektronike: kurora@hotmail.com

(Autori i këtij tekste është përgjegjës i integritimit të të huajve për regjionin La Cote që përfshin këto qytete: Nion, Rolle, Gland, Morges. Për më shumë informata konsultoni faqen e internetit www.integrationvaud.ch)